



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.2134/1 prot.

Tiranë më 23.12.2022

Lënda: Dhënie mendimi për projektligjin “*Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara*”.

KRYEMINISTRISË

DEPARTAMENTIT RREGULLATOR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “*Zyra e Komisionerit*”) ka administruar shkresën tuaj nr. 4232/3 prot., datë 13.12.2022, protokolluar me tonën me nr. 2134 prot., datë 15.12.2022, përmes së cilës dërgohet për mendim projektligji “*Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara*”.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së projektligjit, Zyra e Komisionerit vlerëson se në tërësi nga përmbajtja e tij, ky projektligj zbaton standardet e mbrojtjes së të dhënave personale, si një akt që synon të jetë i harmonizuar plotësisht me legjislacionin evropian në këtë fushë, i cili do të përmirësojë kornizën aktuale ligjore për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara. Megjithatë, do të vlerësonim marrjen në konsideratë nga ana juaj të sugjerimeve në vijim.

Lidhur me nenin 3 të projektligjit “*Përkufizime*”, konstatohet se në pikën 30 të tij, jepet përkufizimi i termit “pseudonim”.

Duke qenë se ky term përmendet në mënyrë specifike në projektligj, Zyra e Komisionerit vlerëson se në përputhje, edhe me legjislacionin e ri që pritet të miratohet në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, që synon përafrimin me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale/GDPR, të përfshihet edhe një përkufizim në lidhje me procesin e pseudonimizimit si një masë tekniko organizative që garanton sigurinë e të dhënave personale, duke i bërë referencë legjislacionit specifik të fushës, dhe më konkretisht:

“Pseudonimizim” sipas këtij ligji ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.”

Lidhur me parashikimin e nenit 21 të projektligjit “Kërkesat e sigurisë për t’u përmbushur nga Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimeve të besuara”, Zyra e Komisionerit konstaton se në pikën 2 të nenit 19 të Rregullores (BE) 910/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 23.07.2014 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm që shfuqizon direktivën 1999/93/KE” me të cilën ky projektligj përafrohet, parashikohet detyrimi për ofruesit e shërbimeve të besuara të kualifikuara ose jo, që, në rast shkelje të sigurisë apo humbje të integritetit që cenon të dhënat personale, të njoftojë edhe autoritetin e mbrojtjes së të dhënave.

Ky është një detyrim që shkon në të njëjtën linjë edhe me përcaktimet e kuadrit rregullator evropian të mbrojtjes së të dhënave (konkretisht nenin 33 të Rregullores së Përgjithshme Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale/GDPR) dhe së shpejti do të përfshihet edhe në legjislacionin vendas i cili është në proces përafrimi të plotë me këtë Rregullore.

Për këtë arsye, Zyra e Komisionerit vlerëson se pas pikës 3 të këtij neni, duhet të përfshihet një pikë me këtë përmbajtje:

“Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimeve të Besuara” në rastet e shkeljes së sigurisë apo humbje të integritetit që kanë ndikim të rëndësishëm në të dhënat personale duhet të respektojnë parashikimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale për të njoftuar autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Me përfshirjen e sugjerimeve të sipërcituara, projektligji vlerësohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi